



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 544/7 Prot

Tiranë, më 19.09.2016

V E N D I M

Nr.103, Datë19.09.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS TIRANË "MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT DOGANOR NË PROCESIN E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE DOGANORE."

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standarteve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e legjislacionit doganor në procesin e realizimit të të ardhurave doganore", për periudhën 01.01.2015-31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1 Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të mëparshme të lidhura me shpërblimin e dëmit është zbatuar pjesërisht pika nr. 1 e rekomandimeve të lëna nga KLSH, sipas aneksit nr. 1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm. Rezulton se për 67 raste me detyrim të llogaritur në vlerën 14,173 mijë lekë, janë nxjerrë 59 vendime administrative në vlerën 9,155 mijë lekë, ose në masën 65 % të shumës së rekomanduar për shpërblim dëmi. Gjithashtu, nuk është zbatuar pika 2, në vlerën 57,581 mijë lekë e përbërë nga 41 raste sipas aneksit nr. 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Detyrimet vinin si rezultat i veprimeve të kryera jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 61/12, datë 24.05.2012, "Për Akcizat në RSH".

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 15-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për ndjekjen e praktikave që mundësojnë zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në vlerën **62,599 mijë lekë** përmes verifikimeve doganore pranë Autoriteteve Doganore Homologe për praktikat doganore që lidhen me rekomandimet e lëna në Aneksat nr. 1 dhe 3.

Nga Auditimi i Brendshëm i DPD, të analizohet përgjegjësia institucionale për zvarritjen e përgjigjeve që do të mundësonin arkëtimin në buxhet të shumave të konstatuara si shmangie të detyrimeve doganore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Nga auditimi rezulton se 49 % e borxhit doganor gjendje në fund të vitit 2015 është mbështetur nga Autoriteti Gjyqësor Tiranë me urdhra ekzekutimi në vlerën 2,059,589 mijë lekë, veprim i cili deri këtu tregon për punën jo të mirë që ka bërë Zyra e Borxhit Doganor. Niveli i arkëtimit të borxhit paraqitet shumë i ulët, duke treguar për punën e pamjaftueshme që kanë bërë strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe strukturat e tjera të shtetit të ngarkuara me ligj për të mbështetur rikuperimin e borxhit doganor.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 105-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrin masa konkrete, për të zgjidhur problemet që pengojnë rikuperimin e borxhit doganor në vlerën 4,196,893 mijë lekë, duke angazhuar të gjitha strukturat e specializuara për të zbatuar hap pas hapi kërkesat e legjislacionit doganor nëpërmjet një programi të posaçëm, për vendosjen e sekuestrove ekzekutive për të gjithë ato subjekte që rezultojnë në gjendje debitorë në vlera të mëdha.

Në vijimësi

3. Nga auditimi u konstatua se nuk disponoheshin dosje vlere për subjekte të ndryshme, të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm e të nevojshëm, me qëllim pranimin e çmimit me transaksion, në përlllogaritjen e vlerës doganore, veprime që nuk përputhen me kërkesat e neneve 34-40 të KD, udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave, si edhe me të dhënat e disponueshme të miratuara nga komisioni i Ministrisë së Financave.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 18-88, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë, për secilin nga operatorët ekonomikë që nuk kanë të depozituar dosjet e vlerës, të marrë masa konkrete për krijimin dhe plotësimin e tyre me të gjitha dokumentet e domosdoshme, të inventarizuara dhe të arkivuara pranë sekretarisë së Degës Doganore Tiranë.

Në vijimësi

4. Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura nga Sektori i Mbikëqyrjes së Regjimeve u konstatua se, gjatë vitit 2015 Dega e Doganës Tiranë nuk ka përgatitur dhe nuk ka miratuar programe kontrolli vjetor, për të kontrolluar procedurat doganore që kanë zbatuar operatorët ekonomik gjatë funksionimit të regjimit të magazinave doganore, por as Programe për Inventarizimin Vjetor të gjendjes fizike të mallrave që gjendeshin në ambientet e subjekteve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Kontrollat e ushtruara gjatë vitit 2015 nga doganierët e sektorit të mbikëqyrjes së regjimit të magazinave doganore janë kryer në bazë të disa plan-kontrolleve verifikuese të përgatitura në momentin e fillimit të kontrollit dhe janë miratuar nga Kryetari i Degës së Doganës, por në asnjë rast ato nuk janë bazuar në metodën e analizës së riskut e cila pothuajse nuk është njohur dhe nuk është zbatuar asnjëherë nga ky sektor.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr 88-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masa, që kontrollet e ardhshme të procedurave që kryhen gjatë zbatimit të regjimit të magazinave doganore të realizohen në bazë të Programeve Vjetore të përgatitura mbi bazën e analizës së riskut, me drejtime, afate kohore dhe persona përgjegjës të përcaktuar.

Menjëherë

5. Nga auditimi i ushtruar mbi dosjet e operatorëve ekonomikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, paraqitur nga Sektori i Mbikëqyrjes së Regjimeve për vitin 2015, u konstatua se, në disa prej tyre mungonin dokumente kryesore si, Ekstrakti i Regjistrimit të subjekteve në QKR, garancia vjetore e depozituar pranë DPD-së, e llogaritur nga autoriteti doganor kompetent në bazë të legjislacionit në fuqi, me vlerë deri në kufirin e mbulimit të plotë të detyrimeve doganore që mund të lindin gjatë kryerjes së procedurave doganore. Ndërsa disa dosje ishin të mbingarkuar me dokumente të pa nevojshëm. Dokumentet në dosje ishin të pa inventarizuara.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr 88-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masa konkrete për të plotësuar të gjitha dosjet e subjekteve me dokumente të përcaktuara me ligj, të kryhet inventarizimi fizik i tyre dhe më pas të depozitohen me procesverbal në arkivin e doganës.

Menjëherë

6. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" neni 44 "atributet dhe kompetencat", pika 2, germat a, b dhe neni 48 "ruajtja e dokumentacionit", pika 4, lidhur me mos vendosjen e shërbimit doganor (24 orë), në ambientet subjekteve [REDAKTUAR], Shoqëria [REDAKTUAR] dhe Shoqëria [REDAKTUAR], të cilët kanë fituar statusin e Depozituesit të Miratuar, dhe paraqesin risk të lartë.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr 119-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Degën e Doganës Tiranë të urdhërojnë Depozituesit e Miratuar të trajtuar sa më sipër të marrin masa konkrete për krijimin e Zyrave Doganore brenda ambienteve të tyre, t'i kompletojnë ato me të gjitha pajisjet e nevojshme për një zyre shtetërore, me kompjuter, matësa lëngjesh (birrë) dhe pajisje të domosdoshme fiskale.

Menjëherë

7. Kontrollat e ushtruara gjatë vitit 2015 nga Sektori i Akcizës, nuk janë kryer në bazë të programeve vjetore të kontrollit, të përgatitura dhe të miratuara nga Kryetari i Degës Doganës, por sipas disa urdhra pune verifikuese të momentit të nënshkruara nga autoriteti doganor kompetent. Kontrollat doganore të ushtruara nuk ishin të bazuara në analiza risku ku të ishin zbatuar teknika elektronike të përpunimit të të dhënave me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, për të përcaktuar më pas masat kundër vepruese të nevojshme dhe në bazë të kriterëve të hartuara në nivel kombëtar, këto veprime bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në RSH", neni 45 "Kontrolli doganor", pikat 2 dhe 6. Kontrollat e ushtruara gjatë vitit nga doganierët e akcizës nuk janë të plotë, ato nuk përfaqësojnë në asnjë rast një kontroll të përgjithshëm të aktivitetit të kryer nga Depozituesit e Miratuar, duke filluar nga gjendja e lëndëve të para, produktet e akcizës, në proces dhe të gatshme, kontrollin e depozitave, kontrollin e numrit të pajisjeve të prodhimit të linjave të instaluara dhe të deklaruara, ndërtesat ose AQT (aktivet e qëndrueshme të trupëzuara), verifikimin e mjeteve të transportit, përfshi dhe kontrollin e gjendjes së Pullave Fiskale.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 119-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë, para se të fillojë kontrollat dhe inventarizimet fizike vjetore të mallrave në ambientet e Depozituesve të Miratuar të marrë masa të plota për përgatitjen e programeve vjetore të posaçme ku të përfshihen të gjithë operatorët e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me drejtime të përcaktuara, afatet kohore konkrete dhe personat përgjegjës.

Menjëherë

8. Nga auditimi i operatorëve që kanë përfitur statusin Depozitues i Miratuar dhe kanë ushtruar aktivitet në fushën e prodhimit-përpunimit-stokimit-tregtimit dhe lëvizjes së mallrave të akcizës nën pezullim u konstatua se: inventarët e kryera nga doganierët e Sektorit Akcizës nuk janë kryer sipas procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim, por janë mjaftuar me kryerjen e një

inventari fizik pjesorë (jo vjetor) në një datë të caktuar për gjatë vitit 2015, duke i krahasuar rezultatet e arritura me gjendjen e regjistruar në kontabilitet.

Veprime këto, të cilat bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", neni 44, "atributet dhe kompetencat", të VKM nr. 612, datë 05.09.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat", neni 67, "Inventarizimi i magazinës fiskale nga autoritetet doganore", neni 68, "procedurat e inventarizimit", neni 69, "tepricat dhe mangësitë në inventarizim", si dhe kërkesat e ligjit nr. 9928, datë 29.04.2014 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar, neni 7, pika 1,2.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 119-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë, për kryerjen e inventarëve fizik vjetor në ambientet e përfituesve të statusit Depozitues të Miratuar, më parë duhet të përgatisë programin vjetor të inventarizimeve, të përcaktojë komisionet e inventarizimit, të vendosë afatet kohore mbi periodicitetin e kryerjes së inventarëve të radhës, të miratuara nga Kryetari i Degës së Doganës.

Në Vijimësi

9. Nga auditimi i ushtruar mbi dokumentet e paraqitura nga Sektori i Akcizës, lidhur me administrimin e Regjistrimit të Shkeljeve të konstatuara në fushën e akcizës rezultoi se, ky regjistër nuk është administruar nga doganierët e akcizës dhe se shkeljet e konstatuara nuk janë dokumentuar për çdo rast dhe për çdo subjekt, duke penguar kështu pasqyrën e historikut të shkeljeve doganore. Historiku i shkeljeve doganore vlen për nxjerrjen e vendimeve administrative nga autoriteti doganor kompetent në vijimësi, për subjektet e prodhimit dhe të tregtimit të produkteve të akcizës në rastet e shmangies nga verifikimi dhe pagimi i akcizës. Nga doganierët e sektorit të akcizës pretendohet se këta regjistra administrohen nga Zyra Juridike, por pretendimi nuk qëndron.

Ky veprim bie ndesh me kërkesat e ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë" kreu XII, neni 86, pika 2, "Penalitetet për të gjitha shkeljet e kryera me produktet e akcizës gjatë proceseve të prodhimit-depozitimit dhe lëvizjes rregullohen nga ky kre".

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 119-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masa konkrete për vendosjen e regjistrave të sekretuar, pranë Sektorit të Akcizës, ku të regjistrohen të gjitha shkeljet doganore të konstatuara në fushën e akcizave dhe të përgatitet Data Base përkatës, me të gjitha shkeljet, llojet shkeljeve, rastet përkatëse për çdo operatorë në sasi, vlerë dhe penalitetet e aplikuar.

Menjëherë

10. Nga auditimi dhe verifikimi i dokumenteve që ndodhen në dosjet e operatorëve ekonomik, që kanë fituar statusin e Depozituesit të Miratuar të Magazinës Fiskale, administruar nga doganierët e akcizës u konstatua se, ato nuk janë mbajtur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" neni 48 "ruajtja e dokumentacionit", pikat 1, 2 dhe 3. Të

meta dhe mangësi të shumta u konstatuan në ambientet e Sektorit të Akcizës, ku dokumentet dhe dosjet përkatëse nuk ishin të mbrojtura, të ruajtura dhe të administruara në dosje, për secilin operator ekonomik në vite, ato nuk ishin dorëzuar dhe nuk dorëzoheshin me inventar dhe me procesverbal dorëzimi nga doganieri dorëzues tek doganieri marrës në dorëzim.

Të gjitha dokumentet që ndodheshin në këtë zyrë doganore ishin të pa sistemuara, të pa inventarizuara, ato nuk ishin përzgjedhur sipas rëndësisë dhe afateve të ruajtjes, nuk ishin të depozituara në asnjë rast në arkivin e Degës së Doganës Tiranë, veprim i cili bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003, "Për Arkivat" neni 24 geramat a, b dhe c, neni 9 geramat b, c, ç, d. si dhe "Rregullat për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore dhe jo shtetërore".

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 119-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për seleksionimin e të gjitha praktikave shkresore që ndodhen në ambientet e Zyrës së Akcizës duke i ndarë ato në dosje të veçanta sipas viteve që nga tetori i vitit 2012 deri më 31.12.2015. Praktikave me vlera dokumentare të rëndësishme të inventarizohen sipas viteve dhe të depozitohen me procesverbal dorëzimi në arkivin e doganës. Ndërsa dosjet që janë në përdorim të inventarizohen dhe t'i dorëzohen me procesverbal dorëzimi doganierëve që janë marrëdhënie pune me autoritetin doganor kompetent.

Menjëherë

11. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për Regjimet e Përpunimit Aktiv rezultoi se subjekti ██████ Sh.p.k me NIPT L11415016S me sistem pezullues, nuk ka riekportuar mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv me sistem pezullim në sasinë 8182.47 kg me vlerë 107290.51 € në shkelje të pikës 8 të autorizimit dhe nenit 256.1/a, 256.2, 256.4, 271.1 dhe 271.2/a të KD. Nga ana e sektorit të regjimeve nuk rezultoi të jetë bërë kontroll lidhur me verifikimin e mallrave të pariekportuara si produkt kompensues referuar kërkesave të nenit 271.2 të Kodit Doganor.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 99-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Dega e Doganës Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa përkatëse sipas kërkesave ligjore referuar nenit 271.2 të Kodit Doganor të ushtrorë kontroll në ambientet e subjektit ██████ Sh.p.k për verifikimin e diferencave të rezultuara dhe referuar legjislacionit doganor të mbajë aktet administrative për penalitetet përkatëse.

Brenda datës 30.10.2016

12. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe procedurave të ndjekura në deklarimin e mallrave, rezultoi se për DAV, me **R-10560**, datë 11.11.2015, subjekti ██████ me NIPT K86618008S ka importuar dhe deklaruar artikullin 6 dhe 7 "Kimikate për foto dhe Kimikate për rreze", në kodin tarifor *37079020* çmimi i transaktuar është shumë poshtë të dhënave të disponueshme të publikuara në faqen zyrtare të DPD deri më datë 22.07.2015 (shfuqizuar me shkresën e DPD nr. 15861 prot, datë 22.07.2015 "Shfuqizim të dhënash nga Dosja e të Dhënave të Disponueshme").

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen nr. 72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masat përkatëse për verifikimin e vlerave të transaktuara me Institucionet Homologe lidhur me vërtetësinë e dokumentacionit tregtar bashkëlidhur praktikës doganore mbi bazën e të cilit janë llogaritur detyrimet doganore.

Brenda datës 30.10.2016

B. MASA ADMINISTRATIVE

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me vlerësimin doganor rezultoi se nga agjencitë doganore, të cilat operojnë pranë Degës së Doganës Tiranë, janë trajtuar me MSABE dhe janë keqklasifikuar artikuj me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, në shkelje të neneve 256.1/a; 256.2; 261.1; 261.2 dhe 261.3 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 18-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit, të marrë masa bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor si dhe nenit 41.2 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, për penaltet në masën 50,000 deri në 200,000 lekë, deri në shfuqizim liçence për agjencitë doganore: [REDAKTUAR] me nr. J003, [REDAKTUAR] me nr J033, [REDAKTUAR] me nr. J005, [REDAKTUAR] me nr. J009, [REDAKTUAR] me numër J047, [REDAKTUAR] me nr. J092;

Menjëherë

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Dega e Doganës Tiranë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e efektit financiar në vlerën **383,887,201 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe procedurave të ndjekura në deklarin e mallrave, rezultuan raste të: trajtimit me origjinë preferenciale të artikujve me deklaratë faturë vlera e të cilëve e kalon 6000 euro; keqklasifikimit të artikujve; shqyrtim jo si duhet i vlerës doganore të mallrave dhe gjatë verifikimit të sasisë së deklaruar, sasi tepër të mallrave të deklaruara, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2 të Kodit Doganor si dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 18-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e

tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **154,199,463 lekë** nga subjektet sipas anekseve nr. 1-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.10.2016

2. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar, praktikave doganore të përzgjedhura të subjekteve të cilët kanë operuar në kushtet e autorizimeve të regjimeve ekonomike rezultuan se: nga subjektet të cilët për mallrat e importuara që kanë përfituar përjashtim me pezullim të detyrimeve doganore në kushtet e Regjimit të Përpunimit Aktiv, nuk janë rieksportuar produktet kompensuese si dhe operatori ekonomik nuk ka paraqitur pranë Degës Doganore materialin e mbylljes së regjimit, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.1/a, 256.2, 256.4, 271.1 dhe 271.2/a të Kodit Doganor si dhe kërkesave të nenit 6 pika 3 dhe nenit 15.pika 2.3.4 të Udhëzimit nr. 1, datë 06.09.2012 të D.P.D “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 99-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **10 raste**, në vlerën **7,344,051 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.10.2016

3. Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore rezultuan vendime të marra nga Autoriteti Doganor: të pa kontabilizuara nga zyra e financës; për subjekte që kanë rezultuar me shkelje me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, nuk është vendosur penalteti përkatës; për subjekte që operojnë në kushtet e RPA nuk janë penalizuar referuar natyrës së shkeljes; si dhe penaltete të marra jo në masën e duhur në përputhje me legjislacionin veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 232.1 si dhe kërkesat e pikës 4 gërmat “b, c, d, e, f” të Udhëzimit nr. 6, datë 23.07.2013 të DPD “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit dhe kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe të akcizës”, 256.2, 275.1, 271.2/a/b, 261.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 110-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **13 raste**, në vlerën **8,842,811 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.10.2016

4. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe shkresor në lidhje me përgjigjet e analizave nga Laboratori Kimik Doganor si dhe procesverbalet e mbajtura për shkelje në fushën doganore, rezultuan se: për përgjigjet e analizave (për disa subjekte), nga Laboratori Kimik Doganor edhe pse ka patur keq klasifikim në kodin tarifor të

artikujve të deklaruar, nga sektori aposterior, nuk është mbajtur procesverbal konstatimi: për procesverbale të mbajtura për shkelje në fushën doganore nga Autoriteti Doganor nuk është dalë me vendim administrativ, për shkeljet doganore me pasojë shmangien e detyrimeve doganore si nga konstatuesit po ashtu edhe nga Autoriteti Doganor janë mbajtur jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor, shkresa për shkelje në fushën doganore për të cilat nuk është mbajtur procesverbal, apo raste të procesverbaleve të mbajtura për shkelje në fushën doganore, për të cilat Autoriteti Doganor kompetent nuk ka dalë me Vendim Administrativ veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.1/a; 256.2; 261.1; 261.2; 275.2; 285.4; 286; 287.1 dhe 289.1 të Kodit Doganor.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 139-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Dega e Doganës Tiranë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **17 raste**, në vlerën **209,800,876 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.10.2016

5. Vlera prej **500,000 lekë** penalitete të llogaritura për **10** subjekte operatore të regjimit të magazinave doganore, sipas aneksit nr. 14, trajtuar në faqet nr 89-104 të RPA, për mos plotësimin e dosjeve me dokumentacionin përkatës dhe mos dorëzimin e garancisë mallrave në afatet e duhura, për vitin 2015.

Deri më 20.12.2016

6. Vlera prej **3,200,000 lekë** penalitete të llogaritura për **16** subjekte të akcize, trajtuar në faqet nr. 123-146 të RPA, për shkeljen e afateve të kalibrimin dhe certifikimin të depozitave ku administrohen lëngje, të cilat trajtohen me akcizë si birrë, verë, pije alkoolike dhe raki, për vitin 2015.

Deri më 20.12.2016

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës së Doganës Tiranë, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 gërma “a”, “b” dhe “c” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda, të rënda dhe të lehta, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

a. Neni 58 gërma “b-ç”, nga “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” deri në “largim nga shërbimi civil” për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për **znj. G G** me detyrë doganier klasifikim/vlerë
2. Për **znj. E Sh** me detyrë doganier klasifikim/vlerë
3. Për **znj. E B** me detyrë doganier klasifikim/vlerë
4. Për **z. K B** me detyrë doganier klasifikim/vlerë
5. Për **z. A B** me detyrë doganiere regjime/përjashtime
6. Për **z. D S**, me detyrë doganier në Sektorin e Akcizës
7. Për **z. D A**, me detyrë doganier në Sektorin e Akcizës

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

- Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim;
- Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keqklasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD;
- Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0% me deklaratë faturë, jo në përputhje me kërkesat e Titullit V, neni 22 të Udhërrëfyesit “Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale.”, kushtet për lëshimin e një deklarate faturë citon: “...Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22 ose nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera e të cilave nuk i kalon 6000€...”;

b. Neni 58 gërma “a-b”, nga “vërejtje” deri në “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për nëpunësit civil, si më poshtë:

8. Për **z. A N** me detyrë doganier klasifikim/vlerë
9. Për **zj. V H** me detyrë doganiere regjime/përjashtime
10. Për **zj. S D** me detyrë doganier klasifikim/vlerë
11. Për **z. S S** me detyrë doganier në Sektorin e Akcizës,
12. Për **z. G Y** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Akcizës

Për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 15.13 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25 datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme ” dhe në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

- Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrit të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim.
- Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me keqklasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD.

- Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore trajtuar me origjinë preferenciale me nivel të taksës doganore 0% me deklaratë faturë, jo në përputhje me kërkesat e Titullit V, neni 22 të Udhërrëfyesit “Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale.”, kushtet për lëshimin e një deklarate faturë citon: “...Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22 ose nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera e të cilave nuk i kalon 6000€...”.

- Për problemet e konstatuara në lidhje me praktika doganore me sasi tepër deklarimit, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; dhe 261.1 të KD;

Shënim:

Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi doganor ish-punonjësit e poshtë cituar:

z. **M T** në cilësinë e kryetarit, z. **E D** në cilësinë e ish përgjegjësit të vlerësimit doganor/kontroll fizik.

Me ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara me këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 544/10 Prot

Tiranë, më 21/09/2016

V E N D I M

Nr. 107, Datë 21.09.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 103, DATË 19.09.2016 "MBI EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS TIRANË"

Pasi u njoha me ankesën nr. 544/9, datë 21.09.2016, të zj. **E. Sh**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, në Degën e Doganës Tiranë, në lidhje me rishikimin e masës disiplinore, të rekomanduar nga KLSH, në Vendimin nr. 103, datë 19.09.2016, pas vlerësimit të fakteve të reja të paraqitura në observacionin bashkëlidhur kësaj kërkesë, duke marrë në konsideratë mendimin e grupit të shqyrtimit të kërkesës, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Revokimin e rekomandimit për dhënien e masës disiplinore ndaj zj. **E. Sh**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, në Degën e Doganës Tiranë, në Vendimin nr. 103, datë 19.09.2016, i përcjellë në Degën e Doganës Tiranë me shkresën nr. 544/8, datë 20.09.2016.

II. Në lidhje me këtë Vendim, të njoftohet Dega e Doganës Tiranë.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr.544/13.Prot

Tiranë, më 28/09/2016

V E N D I M

Nr.121, Datë 28.09.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 103, DATË 19.09.2016 "MBI EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS TIRANË"

Pasi u njoha me ankesën nr. 544/12, datë 28.09.2016, të zj. **E. B**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, në Degën e Doganës Tiranë, në lidhje me rishikimin e masës disiplinore, të rekomanduar nga KLSH, në Vendimin nr. 103, datë 19.09.2016, pas vlerësimit të fakteve të reja të paraqitura në observacionin bashkëlidhur kësaj kërkesë, duke marrë në konsideratë mendimin e grupit të shqyrtimit të kërkesës, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Revokimin e rekomandimit për dhënien e masës disiplinore ndaj zj. **E. B**, me detyrë doganier klasifikim/vlerë, në Degën e Doganës Tiranë, në Vendimin nr. 103, datë 19.09.2016, i përcjellë në Degën e Doganës Tiranë me shkresën nr. 544/8, datë 20.09.2016.

II. Në lidhje me këtë Vendim, të njoftohet Dega e Doganës Tiranë.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R